



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

PROCESVERBALI – TAKIM PUBLIK ME QYTETARË

Komuna e Pejës – Zyra e Kryetarit

Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Data: 22.06.2026

Ora: 12:00

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës është mbajtur takimi publik me qytetarë, ku të gjithë të interesuarit janë informuar drejtpërdrejt nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri dhe Drejtorët e Drejtorive në Komunën e Pejës për të gjitha çështjet, që janë në kompetencë të pushtetit lokal dhe për të cilat qytetarët kanë shprehur interesim, si: punët e Komunës së Pejës, prioritetet e saj, infrastruktura rrugore, infrastruktura komunale, shërbimet administrative, buxheti etj.

Në takim morën pjesë Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Drejtorët e Drejtorive, Kryetarët e Bashkësive Lokale dhe qytetarët e Komunës së Pejës.

Takimin e hapi Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe u uroi mirëseardhje në takimin publik me qytetarë. Ai theksoi se ky takim është në kuadër të objektivave të komunës për transparencë dhe shërben, si informim mbi punët e komunës, ku qytetarët kanë mundësi të japin sugjerime dhe të parashtrojnë kërkesa.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri theksoi se të hyrat vetanake për gjashtëmujorin e parë kanë arritur shumën prej 2 milionë e 70 mijë euro, ndërsa plani për këtë periudhë ka qenë rreth 3 milionë euro, që do të thotë se është realizuar rreth 45% e të hyrave të planifikuara.

Këtë vit janë planifikuar të hyrat vetanake rreth 6 milionë euro, të cilat përfshijnë tatimin në

pronë, qiratë komunale, parkingjet dhe lejet ndërtimore. Performanca e komunës në këtë periudhë gjashtëmujore vlerësohet e kënaqshme, pasi pagesat e tatimit në pronë realizohen kryesisht në gjashtëmujorin e dytë dhe pritët, që edhe këtë vit të ketë tejkalim të të hyrave vetanake, si vitin e kaluar.

Vitin e kaluar janë realizuar gati 2 milionë euro mbi planin. Nga raporti fillestar shihet se të hyrat do të realizohen dhe mund të tejkalohen në një masë të konsiderueshme.

Deri në këtë moment, shpenzimet për investime kapitale kanë arritur shumën prej 16 milionë euro, ndërsa buxheti i përgjithshëm i Komunës së Pejës për këtë vit është 46 milionë euro. Një pjesë e konsiderueshme e investimeve kapitale ende nuk është realizuar, ndërsa pagat dhe mallrat e shërbimet janë në nivel të planifikuar. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar në 42%, pagat në 49%, subvencionet dhe transferet në 23%, ndërsa shpenzimet komunale në 55%.

Kryetari theksoi se në këtë periudhë ka një tejkalim, prej rreth 5% mbi planifikimin për gjashtëmujorin e parë dhe beson se me të hyrat vetanake dhe shpenzimet do të realizohet plani vjetor financiar.

Më pas u paraqitën projektet në zhvillim. Në sektorin e arsimit, gjimnazi shkencor është drejt përfundimit, ku janë duke u kryer punimet në fasadë, nyjet sanitare, dyert dhe dritaret, me synim përfundimin brenda këtij viti.

Janë nisur renovimet në disa shkolla, si dhe në sallën e sportit në Novosellë. Në shkollën në "Dardani" është duke u bërë renovimi i paraleles së ndarë. Në shkollën e Poçestës është planifikuar renovim i plotë. Në Zahaq dhe në "Vaso Pashë" është paraparë rregullimi i drenazhit dhe largimi i ujërave atmosferike.

Në Trestenik është nënshkruar kontrata për ndërtimin e sallës së sportit, e cila pritët të përfundojë brenda këtij viti, nëse punimet ecin sipas planit. Në Glllogjan, për shkak të ndërprerjes së kontratës me operatorin ekonomik, projekti do të planifikohet për vitin e ardhshëm.

Po ashtu, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, është planifikuar fillimi i ndërtimit të shkollës së re fillore në fshatin Llozhan, e cila pritët të përfundojë brenda dy viteve.

Në sektorin e shëndetësisë, objekti për trajnime është drejt përfundimit dhe pritët të vihet në funksion këtë vit. Ambulanta në Trestenik është pothuajse e gatshme dhe mbetet vetëm pajisja me mobilie. Është planifikuar edhe projekti i ambulantës në Dardani. Në Radavc mbetet ende pa përfunduar objekti i ambulantës.

Në infrastrukturë, janë duke vazhduar disa projekte nga viti i kaluar, ndërsa janë hapur

procedurat për asfaltimin e rrugëve në qytet dhe në disa fshatra, përfshirë edhe rrugën për Shtupeq të Vogël dhe rrugët në Rugovë. Projekti kap vlerën rreth 4.8 milionë euro dhe pritet të tenderohet së shpejti.

Projekti i sheshit nga Ura e Zallit deri te Ura e Re është përfunduar në aspektin projektues dhe pritet të fillojnë procedurat për ndërtim. Për lagjen Kapeshticë janë planifikuar edhe faza të tjera të projektit, ndërsa realizimi i plotë parashihet në vitet 2027–2028.

Në këtë zonë është planifikuar edhe shpronësimi i disa pronave dhe fillimi i rrënimit të objekteve të caktuara pas përfundimit të procedurave.

Sa i përket dëmeve nga fatkeqësitë natyrore është dorëzuar raporti përfundimtar në Qeveri dhe pritet kompensimi i dëmeve për qytetarët e prekur.

Në sektorin e bujqësisë, janë ndarë subvencionet dhe rreth 120 fermerë kanë përfituar pajisje të ndryshme në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë. Për vitin e ardhshëm është planifikuar rritja e subvencioneve dhe mbështetjes për fermerët, përfshirë edhe shpërndarjen e rreth 65 traktorëve, me synim rritjen graduale deri në 100 traktorë në vitet në vijim.

Në fund të raportimit gjashtëmujor, Kryetari kaloi fjalën te qytetarët.

Pjesa e diskutimeve të qytetarëve:

Agim Haxhijaj i përshëndeti të pranishmit. Së pari e pamë një buxhet prej 40 milionëve, i cili është i shpërndarë në të gjitha drejtoritë. Unë dua t'ju përgëzoj për ndarjen e këtij buxheti dhe neve s'na mbetet asgjë tjetër vetëm si Kryetar të Këshillave Lokale t'i marrim të dhënat e sakta për investimet, të cilat duhet të bëhen në lokalitetet tona. Jam shumë i kënaqur me punën e deritashme, me angazhimet, me kërkesat, që unë i kam bërë në bashkëpunim me drejtoritë dhe kemi arritur me realizu projekte madhore duke fillu me salla të sporteve, me rrugë, me asfalte. Unë dua t'ju përgëzoj për shtimin e buxhetit të komunës në bujqësi, me çka do të jetë një ndihmesë e madhe për bujqit tanë. Me të vërtetë i janë kthyer bujqësisë dhe kanë nevojë për investime fillestare dhe gjatë dëgjimeve buxhetore do t'i paraqes edhe kërkesat e mia në Këshillat Lokale kur do të vini dhe unë do të jem pjesëmarrës.

Miftar Aliaj nga fshati Zllapek në kohët e fundit kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë me Kryetarin dhe Drejtoritë përkatëse, por e kemi një shqetësim madhor, që rruga jonë, prej fshatit Loxhë prej xhamisë e deri te lagja jonë jo vetëm, që është e ngushtë, por është shumë e dëmtuar, por kemi bisedu, që në vend të kubëzave mundësisht të na zgjerohet ajo rrugë edhe për një metër e gjysmë, që të kalojmë më lehtë, për arsye se ajo rrugë është bërë si transit i rrugës së Baranit. Ka shumë nevojë me u zgjeru. Ndoshta edhe një dukuri

tjetër është që vozisin me një shpejtësi shumë të madhe, me bisedu edhe me Policinë e Kosovës me bo kufizim të shpejtësisë se përndryshe fëmijët tanë janë shumë të rrezikuar. Sa i përket projekteve të tjera, unë e kam paraqitë kërkesën për varreza, me i rrethu se na kemi varreza familjare dhe sipas mundësive buxhetore me na ndihmu në këtë aspekt. Është edhe çështja e ndriçimit, por është e dorës së dytë dhe nuk është më me rëndësi se këto tjerat.

Arianit Sahatçiu vij nga lagjja "Haxhi Zeka". E kemi një shqetësim në lidhje me lagjen tonë ku banojmë dhe jetojmë që tre shekuj. E para është ndërtimi dhe restaurimi i rrugës, tash e 27 vjet nuk ka asnjë investim në atë rrugë dhe është pjesa kryesore e qendrës. Po ashtu, jam përfaqësues i dy peticioneve me një shqetësim, që e kemi në lagje. Tash na ka ndodhur së fundi ndërhyrje direkte nga Drejtoria për Shërbime Publike në lejen e një objekti afarist ku është kyçur një urë dhe e ka bërë dëmtimin e rrugës dhe e ka ulur sigurinë e qytetarëve, zhurmën dhe cenimin e pronës direkt duke e shkelur lejen e Drejtorisë së Urbanizmit. Ju ka mundësu ilegalisht ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike të pajiset me leje ose me pëlqim pa pasur kurrfarë kriteri, ndërsa është e specifikuar shumë mirë ligji për ndërtim, që i vetmi organ, që mundet me ju dhënë rrugë hyrje-daljeve është Drejtoria e Urbanizmit. E dyta është kemi shumë pengesa në heshtje administrative, ku sa herë kemi kërku me u pajis me informata në lidhje me pëlqimin dhe me kriteret mbi çfarë baze është lëshuar ai pëlqim, na është mohuar direkt qasja në dokumente zyrtare.

Fazli Muriqi nga Rugova ju përshëndes të gjithëve. Kryetari është i njoftuar pak se ne si rugovas kemi dal me kërkesë dhe kemi një këshill organizativ për ngritjen e një shtatoreje të një figure të njohshme të Rugovës, të Sak Faslisë, ish-bajraktarit të Rugovës. Si këshill kemi vendos shumën e vjetër për vendosjen e shtatores është 55 mijë euro, deri më tani janë grumbullu mbi 20 mijë euro dhe nëse komuna mund të na ndihmojë diçka, shpresoj në mirëkuptim nga ju.

Agron Kelmendi jam banor i fshatit Kosuriq. Kryetar na kemi shumë kërkesa, më mirë po ta dorëzoj direkt e zgjidhe njërin prej tyre.

Pas diskutimeve, Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë.

Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në këto takime ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e demokracisë lokale dhe për përmirësimin e shërbimeve komunale.

Takimi u zhvillua në përputhje me nenin 68, paragrafi 68.1 dhe 68.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 91, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Pejës.

Takimi u mbyll në orën 13:00.

Procesmbajtëse:
Ariana Lukaj

Dëgjimi Publik I Parë për Vitin 2026

22 Qershor 2026

Nr.	Emri	Mbiemri	Vendbanimi	Telefoni	Nënshkrimi
1	Janez	Helzenaj	Pejë	049-807323	
2	FITH	DESHARD	NHSEDCGAN	044-621-755	
3	GATHEUO	MURAYHERI	PEJE	045-206 000	
4	ARSHUT	KUEASWIBU	PEJE	045-948 000	
5	FAYE	ZECH	KUTUNALI, VI	049 221-222	
6	ALDOER	GEER	PEJE	044-221-164	
7	ALDOER	CHETRA, Skq/q	PEJE	049295 195	
8	ARDO	MULTOKHA	PEJE	048-555-844	
9	FAYE	ASLEANI	K. PEJE	044 237 238	
10	VANIE OSHANI	DEGHI	PEJE	049-880-055	
11	HAKE, MURAY	RUABUE	PEJE	044-328-454	
12	HAKE, MURAY	RUABUE	PEJE	049-358-450	
13	SHADON	HAJQ	PEJA	044 238-638	
14	AGIH	HAXHIZAJ	K.L. TREBOVIO	049 332-664	
15	ALBERT	REKIBOGAJ	BOGE	048 275-606	
16	MIFSTAR ALIJA	ALIJAJ	F. ZILAPET	0493528070	
17	ADRI	QASHI	PEJE	049 552 912	
18	ALMEDHA	MURKURTAJ	TIKEL	049-445-978	
19	Koshriot Dolegu		Dandami	045 848 000	
20	CHERGUO PRIZI		BOG	035257677	
21	CHERGUO PRIZI		DOBENJIC	049124-577	
22	SEKIM	SEKIM	PEJE	0491530-052	
23	ANHI	GASHI	PEJE	045-105783	
24	KALTRINA	TEROVA	PEJE	049-413-145	
25	BEJAZH LEMAJA	K.K.L. KAKACHO	PEJE	049 460 033	
26	VALBONA	AVDIJAJ	PEJE	049 266-991	
27	YIMTA	MURAY	PEJE	049-401-183	
28	BIERTA	MURAY	PEJE	049-421-148	
29	SHADON	BEJAZH	PEJE	044 432 947	

Dëgjimi Publik I Parë për Vitin 2026

22 Qershor 2026

Nr.	Emri	Mbiemri	Vendbanimi	Telefoni	Nënshkrimi
1	DANIETA	BERDYNAJ	NOVOSELE	049 491 855	
2	Besir	Besir	Peje	045 493 350	
3	Blench	Blench	Peje	049 451-511	
4	Abuta	Shaton	Peje	049-203-366	
5	Frisk	Mustaf	Peje	045 442 759	
6	Lirika	BERDAJOLI	Peje	049 512 121	
7	Vulmet	Gusna	Peje	049 150 255	
8	Arma	Ustaj	Peje	049 438 147	
9	BEKIR	TOLEAJ	Peje	049 786 524	
10	Muharrem	Muharrem	Peje	044 142 254	
11	Emir	Shutaj	Peje	044 327 915	
12	BUDLA DAKA	BE	Peje	049 664 001	
13	Redon	TEJMEVRI	Peje	044 376 006	
14	Rina Begoll	Peje	Peje	049-460-110	
15	Drejtor godi	Peje	Peje	045-105-824	
16	FLAK	MURDA	Peje	049-541-576	
17	MIMOTA	AVRARI	Peje	044 635-925	
18	Ujnie	Gripollu	Mbajtësja Teate		
19	Donika Kompi	Shatony	Peje	044 165 132	
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					